



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 132 / Prot.
19

Patos, më 29/05/2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 21 Maj 2024

Vendi: "Fshati Gjinoqarë njësia administrative Ruzhdie "

Ora e fillimit : 10:00

Ora e mbarimit : 11:00

Dëgjuesë publike me temë: "Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e "PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025".

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025".

Pjesëmarrës: Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj, Zv. Krytare e Bashkisë znj. Ina Sauli, Administrator i njësisë Ruzhdie z. Agim Mesutaj, Drejtore e Financës në bashki znj. Mimoza Shtëmbari, Drejtore e Urbanistikës dhe Shërbimeve znj. Ermenita Mici, dhe rreth 25 pjesëmarrës (Kryetarë të fshatrave, Banorë dhe fermerë të njësisë Administrative Ruzhdie)

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj:

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj:- Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ligjit nr. 119/2014 "Për të

drejtën e informimit” Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025” jemi sot në këtë takim ku padiskutim



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.

Maj 2024

qëllimi i tyre është transparenca e projekteve të organeve vendimarrëse si edhe dhënia e hapësirës për qytetarët për t’ju dëgjuar zëri për të dëgjuar propozimet apo mendimet që ju keni për mënyrën se si bashkia do të shpenzoje buxhetin e vet në të mirë të komunitetit.

Siç e kemi thënë edhe në degjesat e mëparshme ne kemi një rregull për dëgjesat, ku gjithsecili para se të kërkoj fjalën duhet të prezantohet me emër pasi në cdo seancë dëgjimore gjithçka regjistrohet dhe çdo ankesë, propozim apo mendim i juaj do trajtohet në bazë të ligjeve në fuqi. Edhe njëherë ju falenderoj për pjesëmarrjen. Dëgjesën e deklaroj të hapur dhe fjalën i’a kaloj Zv. Kryetares të Bashkisë znj. Ina Sauli

Zv. Kryetarja e Bashkisë Patos znj. Ina Sauli:- Ju falenderoj për pjesëmarrjen, këto dëgjesa janë shumë të rëndësishme për ne pasi na ndihmoni në knalizimin drejt të buxhetit duke i kryer investimet atje ku është më e domosdoshme dhe atje ku janë më të rëndësishme për komunitetin



**Zv. Kryetarja e Bashkisë Patos
Znj. Ina Sauli**

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.

Maj 2024

tuaj. Në dëgjuesën e mëparshme ju kemi pasur disa kërkesa nga ju të cilat janë në proces për t'u verifikuar edhe për të ndërhyrë, ku problematikat më të kërkuara kanë qenë investime në rrugë, ujë të pishëm kanalizeme dhe ndricim.


Drejtorja e Financave znj. Mimoza Shtëmbari: më lejoni të theksoj se problemet tuaja i janë adresuar për buxhetin e vitit 2025 edhe pjesërisht një pjesë e investimeve do të nisin që këtë vit me ndriçimin i cili do të bëhet që këtë vit pasi i është adresuar këtij buxheti.

	<p>Drejtorja e Financave znj. Mimoza Shtëmbari</p> <p>Dëgjuesë publike me temë:</p> <p>“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.</p> <p>Maj 2024</p>
---	--

Kryetar i fshatit Siqecë z. Myftar Sorraj: kemi bërë shumë kërkesa për vite e vite me radhë dhe asgjë nuk është bërë nga bashkia ndaj hajdeni dhe shikojini rrugët e lagjeve që janë katrahurë pasi nuk shkojmë dot në banesa na vjen turp pasi nuk dimë se çfarë t'ju themi njerëzve.

Kryetari i këshillit z. Armand Ahmetaj: - për cilat rrugë bëhet fjalë?

Kryetar i fshatit Siqecë z. Myftar Sorraj:- po flas për rrugët në lagjen “Hysaj” ,“Mesutaj” dhe rruga më lagjen “Xhepaj”. Problem tjetër jo vetëm në Siqecë por në të gjithë njësinë është certifikimi i tokave. Ka tridhjet vjet që kërkojmë azhornimin e tokave, dhe asgjë nuk bëhet

	<p>Kryetar i fshatit Siqecë z. Myftar Sorraj</p> <p>Dëgjuesë publike me temë:</p> <p>“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.</p> <p>Maj 2024</p>
---	--

akoma përse nuk bëhet azhurnimi i tokave? E kam ngritur në çdo takim këtë problem dhe asgjë nuk është bërë ndaj na zgjidhni problemin e certifikimit të tokës. Kërkoj të punohet për hapjen e rrjetit KUZ, pasi kemi shumë problem si edhe kërkoj të ndërhyet urgjentisht në rrugën e varrezave pasi nuk hyn dot makina e funeralit.

Drejtorja e Financave znj. Mimoza Shtëmbari:- e thash pak më parë që do të bëhen. Sot në këtë fazë që jemi bashkia është në procedurën e tenderimit për blerjen e bazës materiale për shtrim të rrugëve dhe këto rrugë do të bëhen brenda viti 2024.



**Drejtorja e Financave
znj. Mimoza Shtëmbari**

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.

Maj 2024

Drejtori i Bujqësisë z. Orges Gollosi: Duke qënë se një nga problemet me shqetësuese të banorëve të zonës suaj është e lidhur me azhurnimin e tokave bujqësore, ne si drejtori jemi në kontakt të vazhdueshëm me hipotekën për t'u zgjidhur sa më parë si problem edhe të gjithë ju të pajisni me dokumentat e pronësisë. Gjithashtu kemi punuar për hapjen e rrugëve të parcelave me administratorët ku specifikisht në fshatin Siqecë kërkojmë të propozohet një vend për hapje rruge për turistët pasi Siqeca është vend turistik. Kërkesat tuaja janë përfshirë në buxhetin e vitit 2024 siç jua shpjegoj edhe drejtoresha e Financës.



**Drejtori i Bujqësisë
z. Orges Gollosi**

Dëgjesë publike me temë:


“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.

Maj 2024


Kryetar i fshatit Siqecë z. Myftar Sorraj:- këto janë vetëm fjalë

Kryetari i këshillit Armand Ahmetaj: Këtë po thotë edhe drejtori i kadastrës. Ato që ne kemi bërë edhe ato që jemi në proces për të bërë, rruga për te ujvarat e Siqecës për të cilën drejtori kërkoj propozime nga ana juaj, është një investim i cili ju prek të gjithëve.

Banor i Njesisë Ruzhdië z. Belul Muçaj: kërkojmë nga ana juaj të ndërhyni në shtrimin e rrugëve të parcelave. Si dhe të investohet në rrugët e brendëshme të fshatit

	<p>Banor i Njesisë Ruzhdië z. Belul Muçaj</p> <p>Dëgjesë publike me temë:</p> <p>“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.</p> <p>Maj 2024</p>
--	--

Drejtor Kabineti z. Arben Semanjaku:- sipas kërkesave tuaja të dala nga takimi i muajit prill ju kemi kërkuar hapjen e rrugëve të parcelave dhe pasi e kemi diskutuar edhe me kryetarin e Bashkisë këtu do të sjellim një mjet Buldozier i cili është në proces tenderimi dhe do të jetë në dispozicionin njsisë dhe do të jetë vetëm në shërbim tuajin pasi për vet terrenin e thyer të njesisë ne nuk mund të sjellim mjet tjetër dhe do të jetë vetëm për hapjen e rrugëve të parcelave

	<p>Drejtor Kabineti z. Arben Semanjaku</p> <p>Dëgjesë publike me temë:</p> <p>“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.</p> <p>Maj 2024</p>
---	---

Administrator i Njesisë Ruzhdie z.Agim Mesutaj:- njësia nuk ka vetëm rrugët e parcelave. Në fshatin Ruzhdie ka tre rrugë në të cilat nuk hyn dot fare. Në fshatin Gjinoqarë keni marrë vendimin që rruga do të bëhet me asfalto beton po në Mashkullorë në rrugën e Grecies nuk del dot pasi është totalisht e pamundur. Po në fshatin Drenie te rruga e pyllit a keni menduar se duhet ndërhyrje per hapje rruge?



**Administrator i Njesisë Ruzhdie
z.Agim Mesutaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.

Maj 2024

Drejtor Kabineti z. Arben Semanjaku:- është i drejtë shqetësimi juaj por si fillim ishte idea që rrugët të shtroheshin më rërë bituminoze por për vet terrenin e thyer të njesisë dhe për fat të keq cilësisë së rërës e cila nuk është e mirë ju vet keni kërkuar që rrugët e lagjeve të mos bëhen me rërë bituminoze pasi nuk është i qëndrueshëm si investim dhe për një hohë të shkurtër ato prap do të prishen.

Zv. Keryetare e Bashkisë znj. Ina Sauli:- kjo ka qenë edhe kërkesa e administatortit të njesisë që investimet të bëhen të plota dhe rrugët e lagjeve të fshatrave të bëhen me asfalt pasi përvoja e mëparshme ka treguar që investimi në shtrimin e rrugëve me rërë bituminoze nuk ka qenë efektiv dhe i shtrirë në kohë ndaj ne jemi të fokuasuar në shtrimin e rrugëve me asfalt duke përfshirë



**Zv. Keryetare e Bashkisë
znj. Ina Sauli**

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.

Maj 2024

edhe kanalizimet me qëllim që investimi të jetë afatgjatë dhe të mos i kthehemi përsëri një rrugë dhe një nga detyrat e lëna nga kryetari për ju ka qenë përlllogaritja e të gjitha rrugëve të cilat kërkohen të shtrohen me asfaltobeton dhe nga ana juaj do të kërkonim mirëkuptim për hapjet e të gjitha gardheve në mënyrë që të kemi mundësi të ndërhyjmë me shtrimin e rrugëve.

Kryetar i fshatit Ruzhdie z Sako Myftaraj: na thoni ta dimë se çfarë ka parashikuar bashkia për të investuar në njësinë Ruzhdie dhe kërkojmë të na realizohen të gjitha kërkesave, si edhe rrugën në Kasnicë duhet të ketë një ndërhyrje.



**Kryetar i fshatit Ruzhdie
z Sako Myftaraj**

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.

Maj 2024

Drejtor Kabineti z. Arben Semanjaku:- informon për investimet e rrugëve të parashikuara për investim përgjatë vitit 2024-2025. Në njësinë Ruzhdie dhe për rrugët e brendëshme do të bëhet mirëmbajtja e tyre me rërë bituminoze ndërsa shtrimi me asfalto beton është marrëveshje kuadër e cila do të tenderohet këtë vit dhe do të vazhdojë për dy vjet investimi. Ndricimi rrugor do të mbulohet deri në fund të vitit 2024, kërkesat e tuaja do të merren të gjitha në konsiderat, themi se do të fillojmë të bëhen që këtë vit, si përshembull investimi i parë do të jetë bërja e ndriçimit në këtë fshat.



**Drejtor Kabineti
z. Arben Semanjaku**

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.

Maj 2024

Kryetar i fshatit Gjinoqarë z. Nuri Gllava:- kërkoj të vihen në zbatim projektit pilot për koshat e plehrave. Kemi një problem tjetër madhor, e them këtë sepse është qendra e fshatit edhe është me probleme të theksuara të rjetit KUZ. Problem tjetër që na shqetëson janë rrugët e parcelave, ndriçimi, rruga kryesore e fshatit. Mjetet e punës të programohen edhe të qëndrojnë në njësi disa kohë në mënyrë që të na hapin rrugët e parcelave.



**Kryetar i fshatit Gjinoqarë
z. Nuri Gllava**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për
hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe
marrja e kërkesave buxhetore për vitin
2025”.**

Maj 2024

Zv. Keryetare e Bashkisë znj. Ina Sauli:- lidhur mbi koshat e mbeturinave do të vijnë këto ditë pasi është folur edhe me drejtorin e Agjencisë së Shërbimeve edhe me Agimin për të përcaktuar piketimet se ku do të vendosen koshat

Kryetari i këshillit Armand Ahmetaj:Nëse nuk keni gjë tjetër për të shtuar ndonjë pyetje për përfaqësuesit e ekzekutivit. Mqse jo unë ju falenderoj për pjesëmarrjen

Konceptoi:
Koordinator i Konsultimit Publik
Suzana Hysenaj

Pranoi:
Sekretar i Këshillit
Refacla Xeba

Tema e Konsultimit: “Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.

